



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 364/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hasan Shala Kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Valon Ramadani kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Nisma për Kosovën, dega në Ferizaj, paraqitur kundër Ismail Ramadani Kryesues i vendvotimit nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Ferizaj, për shkak të mungesave të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 17.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pas afatshme ankesa e Valon Ramadani kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 16.06.2014, nga Valon Ramadani kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën me numër 55, ku pretendon se në vendvotimin nr. 2510 D/02R, gjatë numërimit të votave, kryesuesi i VV Ismail Ramadani, nga LDK, nuk ja ka shënuar 94 vota të fituara në FRK. Pretenduesi i ankesës thotë se dëshmi për këto vota ka vëzhguesin dhe anëtarin VV të subjektit Nisma, dhe kërkon që për këtë veprim të kryesuesit të bëhet përmisimi në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi emrat dhe deklaratat e një vëzhguesi dhe komisionari të Nismës, deklaratën e tij dhe Formularin e Rezultateve për Kandidat (FRK).

PZAP-i, shqyrtoi afatshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pas afatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pas afatshme sepse afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për të gjitha parregullsitë që lidhen me ditën e votimit është definuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelje ligjore për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”*. Ndërsa pala ankuese ankesën e ka parashtruar në PZAP, me datë 16.06.2014 në ora 14:38 nga kjo del se ankesa në fjalë është parashtruar pas afatit të përcaktuar sipas dispozitës së sipërsënuar, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 364/2014 më datën 17.06.2014



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.